



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANORE POGRADEC

Nr 896 Prot.

Datë. 25.06.2024

Lënda: Kërkesë për shpallje publike

Drejtuar: DREJTORISË PËRGJITHSHME DOGANAVE  
DEPARTAMENTI I ANALIZAVE DHE APOSTERIORIT  
SEKTORI I MONITORIMIT TË BORXHIT/TIRANË

Drejtuar: DREJTORIA E BURIMEVE MBËSHTETËSE  
Adresa: Tiranë, Kashar Mëzez, Lagja Fushë Mëzes, autostrada Tiranë-Durrës, km 1  
Qendra "Pajtoni Bussines Center" kati 5.

Në mbështetje të nenit 96 të ligjit Nr.102/2014, datë 31.07.2014 "Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit nr 15 të Drejtorisë Përgjithshme të Doganave "Mbi evidentimin, kontabilizimin dhe rikuperimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe te akcizës" datë 03.12.2018 si dhe referuar pikës 4 të nenit 162 të ligjit Nr.44/2015, datë 30.04.2015 "Kodit të Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë"...."organi publik publikon aktin në faqen zyrtare të internetit dhe.."Ligjit 10279 date 20.05.2010"Per kundervajtjet administrative"- me qellim plotesimin e detyrimit per njoftim te vendimit te marre,per efekt te vijimit te procedurave administrative,

Kërkojmë ju lutem shpalljen publike të vendimit, për

**Subjekti:** "FINTRADE" me Nipt-M12326014L

**Vendimi:** Nr 13 623/2 prot datë 05.06.2024

**Detyrimi:** në vlerën 61.565 ( gjashtëdhjete e nje mije e pesëqind e gjashtëdhjete e pese lekë)

Kërkesa paraqitet e mbështetur në faktin se subjekti është lajmëruar me postë ne po ate adrese qe ka marre njoftimin e procesverbalit si dhe ridërguar por pa pranim.

Për vazhdimësinë e procedurave ligjore është domosdoshmëri data e shpalljes publike. (bashkëngjitur vendimi Nr13 623/2 prot datë 05.06.2024

Ju falenderojmë për bashkëpunimin!

**Kryetari I Degës Doganore**

**Gentjan Berberi**





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË  
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E DOGANAVE  
DEGA DOGANORE POGRADEC

Nr 623/2 Prot.

Datë.05.06.2024

**Vendim Nr 13**

Në cilësinë e Kryetarit, Pasi shqyrtova procesverbalin Nr 623.prot. datë 08.05.2024 të mbajtur nga komisioni për shqyrtimin e deklaratave doganore, mbajtjen e procesverbaleve mbi shqyrtimin e rekomandimeve përfundimtare të lëna nga Auditimi (sipas urdhërit të brendshëm)Nr 257/2 datë 07.03.2024

Në lidhje me subjektin "FINTRADE" me Nipt-M12326014L ,me adresë: Rruga Dervish Hina, arena center, seksioni B/C, kati i 5 Tirane i cili ka marrë dizeni nëpërmjet njoftimit të procesverbalit nr 623/1 prot.dt 08.05.2024- Në datë 21.05.2024.

**Konstatova:**

Nga shqyrtimi I raportit përfundimtar dhe Rekomandimet per Auditimin me objekt {Auditim Përputhshmërie} të mbajtur nga KLSH- me nr 283/93 prot,date 19.02.2024, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me nr 11604/140 prot.datë 20.02.2024-Protokolluar me tonën me nr.257prot.datë 04.03.2024 dhe shqyrtimi I dokumentacionit bashkëngjitur praktikës Në lidhje me subjektin

<i>Subjekti</i>	<i>Nipt</i>	<i>Praktikë Doganore</i>	<i>Datë</i>	<i>Artikull</i>	<i>Kod Tarifor</i>	<i>Origjinë</i>
FINTRADE	M12326014L	R-19310	23.08.2022	Tuba plastik per ujsjelles dhe kanalizime	3917	Maqedonia e Veriut

U konstatua se është pranuar transaksioni dhe pse nuk i plotësonte kushtet për përdorimin e metodës 1 të Rivlerësimit. Deklarata doganore R-1930 datë 23.08.2022/artikulli 1 duhet rivlerësuar duke zbatuar metodën 6 të Rivlerësimit sipas vlerës së të dhënave të disponueshme me 2.3 euro/kg.

*Metoda 6, "Të dhënat e disponueshme"* Kur vlera doganore nuk mund të përcaktohet sipas metodave të mësipërme, ajo përcaktohet në bazë të të dhënave të disponueshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, duke përdorur mjete të arsyeshme, në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme të: a) marrëveshjes për zbatimin e nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT); b) nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë; c) Kreut III, të titullit II, të Kodit Doganor

Duke u ndodhur në kushtet e plotësimit të përmbajtjes së neneve Të Ligjit 102/2014 date 31.07.2014 "Kodi Doganor I Republikës së Shqipërisë" I ndryshuar përkatësisht 49(Kontrolli pas

çlirimit të mallrave), 70. Metoda dytësore për vlerësimin doganor 2a 70/3( përcaktohet në bazë të të dhënave të disponueshme në territorin doganor të Republikës së Shqipërisë, duke përdorur mjete të arsyeshme, në përputhje me parimet dhe dispozitat e përgjithshme të: a) marrëveshjes për zbatimin e nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë (GATT); b) nenit VII të Marrëveshjes së Përgjithshme mbi Tarifat dhe Tregtinë; c) këtij kreu). 74.2/h Borxhi doganor i lindur nëpërmjet mospërbushjes

Pikës 141-165 të VKM nr 651 datë 10.11.2017 Për Miratimin e dispozitave zbatuese të Kodit Doganor(i ndryshuar) Udhëzimi nr 3 datë 23.01.2018 të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë (Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore)---

**U bë Rivlerësimi I Praktikës doganore R-19310 datë 23.08.2022 nga ku rezultoi detyrimi doganor shtesë për tu paguar në shumën 61.565 Lekë.**

Subjekti I lartpërmendur ka marrë dijeni (nëpërmjet lajmërim marrjes në lidhje me procesverbalin e mbajtur nga Komisioni në datë 21.05.2024 dhe nuk ka ngritur pretendime në lidhje me përmbajtjen e procesverbalit .

**Sa me sipër, në bazë të kuadrit ligjor në fuqi :** Ligjit nr 102/2014 datë 31.07.2014 “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, VKM nr 651 datë 10.11.2017 për “Dispozitat zbatuese të Kodit Doganor“ , i ndryshuar, Udhëzimit nr 15 datë 03.12.2018 “Mbi evidentimin ,kontabilizimin e detyrimeve të papaguara doganore dhe të Akcizës , Urdhërit nr 5 date 12.0.2024 nr 814/1prot.datë 12.01.2024 I Drejtorisë Së Përgjithshme të Doganave “Mbi zbatimin e dispozitave për shkeljet në fushën doganore dhe të Akcizës në Republikën e Shqipërisë—**Duke marrë në konsideratë dhe** Raportin përfundimtar dhe Rekomandimet per Auditimin me objekt {Auditim Përputhshmërie} të mbajtur nga KLSH- me nr 283/93 prot,date 19.02.2024, protokolluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave me nr 11604/140 prot.datë 20.02.2024-Protokolluar me tonën me nr.257prot.datë 04.03.2024. Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave nr 11604/141prot.date 07.03.2024 për analizimin dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna në raportin përfundimtar të auditimit të përputhshmërisë për periudhën 01.01.2022-31.12.2022 të ushtruar nga KLSH në Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave / protokolluar me tonën me nr 257/1 datë 07.03.2024 , Procesverbalin Nr 623prot.datë 08.05.2024 të Komisionit për shqyrtimin/zbatimin e rekomandimeve të KLSH

### **Vendosa:**

1. Subjekti “FINTRADE” me Nipt- M12326014L të shpallet debitor – për detyrimin doganor shtesë në vlerën **61.565** ( gjashtëdhjete e nje mije e pesëqind e gjashtëdhjete e pesemijë lekë)
2. Vendimi i shpalljes debitor të regjistrohet në Database të Shkeljeve Doganore.

Ndaj këtij vendimi mund të ushtroni të drejtën e ankimit pranë Drejtorit të Përgjithshëm të Doganave.Ankimim i cili duhet të depozitohet brenda 30 ditëve nga data e njoftimit në DPD Bashkëlidhur duhet të jetë dhe mandat pagesa e 100% detyrimit doganor si dhe garancia 100 % e penalitetit.

